



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Nr. / Prot.

Shkodër, më 22/11/2022

KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

VENDIM

**PËR HAPJEN E PROCESIT TË PJESSHËM ZGJEDHOR
PËR AUTORITETE DREJTUESE, SENAT AKADEMIK DHE PËR ZGJEDHJEN E
ANËTARIT TË BORDIT ADMINISTRATIV, PERFAQËSUES TË STUDENTËVE**

Nr. 1 datë 22/11/2022.

Komisioni Institucional i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 22.11.2022, në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" përkatësisht neni 36, pika 2 dhe 7; neni 39, pika 11; neni 42 dhe 45 të Statutit të USH-së; neni 17 dhe neni 32; Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritete drejtuese dhe Senatit Akademik në USH"; Vendimit të Senatit Akademik nr. 223, dt.07.11.2022 "Për një ndryshim në Rregulloren "Për Organizimin e Zgjedhjeve për autoritete drejtuese dhe senatin akademik të USH-së", si dhe urdhërit nr. 87, datë 21/11/2022" dhe shkresës nr.88, datë 22/11/2022 "Për fillimin e procesit zgjedhor për zgjedhjen e autoriteteve drejtuese, anëtarë të Senatit Akademik, të Fakultetit të Drejtësisë, Fakultetit të Shkencave të Natyres, Fakulteti të Shkencave të Edukimit, Fakulteti të Gjuhëve të Huaja, Fakultetin e Shkencave Shoqërore"; VKM-së nr. 782 datë 26.12.2018; Shkresës së MARS nr. 4673, datë 13.07.2022; Kërkesës për zbatim nr. 3595 për zhvillimin e zgjedhjeve për anëtarin e Bordit të administrimit përfaqësues i studentëve:

VENDOSI:

1. Shpalljen e fillimit të procesit të regjistrimit të kandidatëve për autoritete drejtuese:

- Dekan i Fakultetit të Drejtësisë
 - Përgjegjës i Departamentit të Drejtës Publike
 - Përgjegjës i Departamentit të Drejtës Civile
 - Përgjegjës i Departamentit Infermieri
 - Përgjegjës Departamentit Fizikë
 - Përgjegjës Departamenti Gjermanistikë
 - Drejtues i Qendrës së Strudimeve Albanologjike (QSA)
 - 2 (dy) anëtarëve të Senatit Akademik, 1 (një) pranë Fakultetit të Shkencave të Edukimit dhe 1 (një) pranë Fakultetit të Gjuhëve të Huaja.
2. Shpalljen e zgjedhjeve për anëtarë të Bordit të Administrimit të USH_së, si përfaqësues i studentëve.
 3. Aplikimi i kandidatëve për këto vende fillon nga data **23.11.2022 dhe përfundon më datë 01.12.2022, nga ora 13:00-15:00**. Kandidatët mund të kryejnë aplikimin pranë Sekretarisë së KIZ, kati i dytë pranë Rektoratit të USH-së.
 4. Shpallja e kandidaturave do të bëhet nga KIZ **më datë 05.12.2022** pranë të gjitha fakulteteve të USH-së.
 5. Zgjedhjet do të zhvillohen **më datë 16.12.2022, ora 08:00-16:00**, pranë KZF-ve të fakulteteve përkatëse.
 6. Me qëllim organizimin e zgjedhjeve të mblidhen KZF-të në të gjitha fakultetet përkatëse, ku ka mangësi në anëtarë KZF të marrin masa për të sjellë pranë KIZ kandidatët për anëtarë të KZF brenda datës 30.11.2022.
 7. U kërkohet fakulteteve që, brenda **datës 06.12.2022**, të sjellin pranë KIZ listat emërore të pedagogëve dhe studentëve votues, të miratuara në çdo faqe nga Dekanët e fakulteteve përkatëse. **Më datë 09.12.2022** këto lista emërore do të shpallen publikisht në çdo fakultet.
 8. Kriteret dhe dokumentacioni për t'u emëruar në autoritetet drejtuese përkatëse gjenden tek rregullorja e zgjedhjeve në USH dhe sipas formularëve bashkëngjitur këtij vendimi.
 9. Kriteret dhe dokumentacioni për t'u emëruar anëtar i Bordit, përfaqësues i studentëve janë si më poshtë:
 - Të jetë person me profil publik dhe arritje të shquara brenda dhe jashtë vendit në fushat akademike, menagjeriale, publicistike, ekonomike dhe juridike;
 - Të ketë integritet etik dhe profesional;

- Të mos jetë i angazhuar në funksione drejtuese partiake;
- Të mos jetë i dënuar penalisht me vendim të formës së prerë;
- Të mos ketë konflikt interesi në përmbushje të kërkesave dhe dispozitave ligjore për parandalimin e konfliktit të interesit.

- Dokumentacioni:

- Kërkesë për aplikim
- CV në gjuhën shqipe
- Fotokopje e njësuar me origjinalin e diplomës së universitetit dhe për diplomat e lëshuara nga institucionet e huaja të sillet vërtetimi i njohjes;
- Fotokopje e librezës së punës
- Fotokopje e dokumentit të identitetit
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore
- Vetëdeklarim mbi mosangazhimin në funksionet partiake
- Vetëdeklarim mbi konfliktin e interesit.

10. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Komisioni Institucional i Zgjedhjeve

Kryetar.

Fatjon Nurja



Sekretar

Megan Krahi



Anëtarë

Arian Gjura.



Ingrit Tirana



Sebastjan Mjekaj



Marsel Nilaj



Megan Krahi

